

AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GRENZA" SHPK



DATA: 14.10.2024

**AKTI I THEMELIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "GRENZA" SHPK**

KREU 1

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

1. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "GRENZA" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2

SELIA

2. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Frang Bardhi, Ndërtesa nr.3, Hyrja 1, kati 4, Apartamenti 5.

NENI 3

KOHËZGJATJA

3. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar
- 3.1 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.
- 3.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të asamblesë së ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

4. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
 - Në fushën e ndërtimit;
 - Projektim dhe zbatim i objekteve të ndryshme civile dhe industrial;
 - Konsulencë në fusha të ndryshme, sipas licensimeve që do të pajiset Shoqëria në të ardhmen sipas legjislacionit shqiptar;
 - Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesmarrëse;

AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

- Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronare trualli apo objektsh;
 - Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë, por pa u kufizuar në; ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/se burimeve nëpërmjet shqerive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.
- 4.1 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU 11

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

5. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000,00 lekë (Njëqind mijë), lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- Ortaku themelues, Zj.Arta Gjergj Mhilli, Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000,00 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

NENI 6

ZMADHIMI I KAPITALIT

6. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute pas kërkesës së Administratorit.

NENI 7

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

7. Zvogëlimi i kapitalit lejohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statusit.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

- 7.1 Në të gjitha rastet edhe zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet eksperteve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së përcaktuar të Asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

8. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU 111 ORGANET VENDIMARRËSE

NENI 9 ASAMBLEJA E ORTAKËVE

9. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.
- 9.1 Asambleja e Ortakëve miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

- Ndryshimin e statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë;
- Emërimin dhe shkarkimin e Likujduesve dhe Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërblimeve për personat në gerat "c" dhe "d" të kësaj pikë;
- Mbikëqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratori, përfshirë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhim dhe zvogëlim të kapitalit;
- Përfaqësim të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizim dhe prishje të shoqërisë;
- Shndërrimin në një formë tjetër;
- Miratim të rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti;

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme në bazë të një autorizimi, nga nje ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Autorizimi për përfaqësim të ortakut mund te jepet dhe të jetë i vlefshëm vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në të njëjtin rend dite.

Administratori i Shoqërisë, nëse është një person i tretë i ndryshem nga Ortakët e Shoqërisë, nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga një ortak i vetëm, ortakut i vetëm ka të drejtë që të lëshojë autorizime për persona të caktuar që këta persona të përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhënie kundrejt të tretëve.

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim ose një njoftimi nëpërmjet postës elektronike nga Administratori i Shoqërisë me kërkesë të ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes, si dhe rendin e ditës, dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas përcaktimeve sipas këtij neni, ajo mund të marrë vendime që konsiderohen të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 11
KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave që janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të ngrihet për shkak të mungesës së Kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, në të njëjtin rend dite.

NENI 12
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithshme zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme të cilat janë të vlefshme kur janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë me shumë se gjysma e numrit total të kuotave. Çdo ndryshim statuti i shoqërisë nga Asambleja e Përgjithshme, i bërë konform dispozitave të paracaktuara, duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Shoqëria do të administrohet nga një administrator, që do të përcaktohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkoj Administratorin me një shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata për shkelje të ligjit dhe me kërkesë të çdo njërit prej ortakëve.

Përcaktimi i administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori i shoqërisë mund të emërohet ortaku i saj ose dhe një person jashtë ortakërisë.

NENI 14
KOMPETENCAT



AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

Administratori ka të drejtë:

1. Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
2. Të përfaqësoj shoqërinë tregtare;
3. Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Supervizon përgatitjen e pasqyrave financiare dhe bilancin vjetor si dhe miraton raportet e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet e shpërndarjeve të fitimeve i paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
5. Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sic parashikohet në Ligjin për Qendrën Kombëtare të regjistrimit;
7. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut;

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

1. Me kërkesë të secilit nga ortakët e shoqërisë;
2. Për qëllim parashtrimin e raporteve financiare bilanceve vjetore si dhe raporteve të tjera objekt miratimi i Asamblesë së Përgjithshme;
3. Në raste kur ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve dhe në vazhdim;
4. Si dhe detyrimet e tjera të parashikuara nga ligji për tregtarët dhe shoqërite tregtare;

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizik e juridik, publik dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqipëtarë apo të huaja, përfshi këtu autoriteteve gjyqësore të të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me marrëdhënie me të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kopetencave që ligji ja jep shprehimisht Ortakëve të Shoqërisë.

Administrator angazhon shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë, si dhe kopetencat e administratorit të saj.



NENI 15

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga Asambleja e Përgjithshme sipas dispozitave dhe mënyrës së miratimit të përcaktuara në këtë statut, që i sjellin dëme shoqërisë i ngarkohen Administratorit, si dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen (në rastet kur), për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara bazuar në Ligj dhe Statut.

Përveçse është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare".

Administratori detyrohet:

1. Të kryejë detyrat e përcaktuara në Ligj e në Statut në mirëbesim e në interesin me të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
2. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim ;
4. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë;
5. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

KREU V

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 16

KONTROLI FINANCIAR

16.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

NENI 17
VITI FINANCIAR

17.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 18
BILANCI VJETOR

- 18.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 18.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 19
DIVIDENDI

- 19.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve miraton Bilancin Vjetor e paraqitur nga Administratori.
- 19.2 Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së Dividentit pasi ti jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar sic edhe parashikohet nga ligji.

KREU VI
SHPERNDARJA OSE LIKUIDIMI I SHOQERISE, BASHKIMI, NDARJA,
SHNDERRIMI

NENI 20
SHPERNDARJA OSE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Shpërndarja ose Likuidimi i Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themlimin e saj;
2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. Me vendim gjykate;
5. Cdo forme apo rrethane tjeter e parashikuar nga Ligji.

Prishja e Shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, me përjashtim të rasteve, kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët në vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

Në rastet kur nuk është përcaktuar nga ana e ortakëve të Shoqërisë një likuidues, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një Likuidues.

NENI 21

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUIDUESVE

21. Detyra e Likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rradhën e preferimit sipas nenit 605 të Kodit Civil.

21.1 Likuiduesi mund të kryejë dhe veprime të reja tregtare pr mbylljen e nj veprimi te papërfunduar.

21.2 Nëse në bazë të pretendimeve të ngritura nga Kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare likuiduesit vërejnë se Shoqërisë tregtare, përfshire kontributet e pa shlyera nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, Likuiduesi detyrohet të pezullojë procedurën e Likuidimit e t'i kërkojë Gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 22

PËRFUNDIMI I LIKUIDIMIT

Pas Shpërndarjes së Aktiveve të mbetura, Likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e Likuidimit dhe kërkon ç'regjistrimin e Shoqërisë në përputhje me Seksionin 5 të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 23

BASHKIMI

Dy ose më shumë Shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjithë aktiveve dhe pasive të njëjës apo me shumë shoqërive që quhen shoqërite përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese e quajtur Shoqëria Përthithëse.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet apo pasivet e shoqërisë ekzistuese, që bashkohen në këmbim të kuotave në shoqërine e re.

NENI 24

NDARJA

Rastet kur mund të ndahet një Shoqëri:



AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

1. Një Shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë Shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008
3. Shoqëritë që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyre solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) Kalimin e shoqërisë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet në përputhje me raportin e ndarjes të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive si dhe për palët e treta;
- b) Berjen e aksionerëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionare apo ortake të një ose me shumë shoqërive pritëse në përputhje me raportin e ndarjes përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe ç' regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas seksionit 5 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", pa kryerjen e likuidimit.

NENI 25

SHNDERRIMI

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shndrrimit të saj në shoqëri aksionere. Kjo nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marre përsipër ndaj të tretëve.

KREU VII

MOSMARRËVESHJET, BAZA LIGJORE, DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 26

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet që mund të lindin, mund të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së parë Tiranë.

NENI 25

BAZA LIGJORE

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji Nr 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregetarët dhe Shoqëritë Tregtare";
3. Ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

AKT THEMELIMI DHE STATUT "GRENZA" SHPK

4. Kodi Civil;
5. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i Ndryshuar;
6. Ligji nr. 8449, date 27.01.1999 " Kodi Doganor", i Ndryshuar;

NENI 26

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky statut u përpilua në 2 (Dy) kopje me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, u miratua Nen per Nen nga Ortaku Themelues i Shoqërisë Tregetare "Grenza sh.p.k".

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Arta Gjergj Mhilli

Arta Mhilli 